



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja 'c', të Ligjit, Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", nenit 5, të Ligjit, Nr.03/L-087, për Ndërmarrjet Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.31/2008" dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr.04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-009, e në mbledhjet e nenëve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01/Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.03.2018, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Suharekës për Ndërmarrjen Publike Lokale, "Ekoregjioni", me këtë përbyrje të re:

1. Gazmend GASHI—— i emëruar nga Kuvendi i Komunës ——anëtar
2. Dardan BERISHA—— i emëruar nga Kuvendi i Komunës ——anëtar
3. Enver SHABANI—— i emëruar nga Kryetari i Komunës ——anëtar

Neni 2

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuara me Ligjin, Nr.03/L-087, për Ndërmarrjet Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.31/2008" dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr.04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-009, lidhur me Ligjin Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.39/2008" dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

Neni 3

Për punën që do ta kryej komisioni do të kompensohen nga 50% për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbledhë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ekoregjioni" Sh.A, me seli në Suharekë.

Neni 4

4.1 Mandat i anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat atë sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kur do herë që kërkojë.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyr në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kupim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr.03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-8449, i datës 01.12.2014, për formimin e komisioni komunal i aksionarëve.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr-101-13994
Me datë 28.03.2018

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KYÇI

